

VIZION

Duke ndihmuar ortakët tane, partnerët dhe klientët në rritjet e vazhdueshme të kërkesave të tyre për realizimin e objektivave të marra, synojmë që të jemi pike referimi në gatishmëri për të mbrojtur dhe rritur potencialin e përvetshëm dhe atë të përbashkët.

MISIONI

Në një treg gjithnjë e më konkurrues dhe seleksionues duam të shtojmë një vlerë të re ndaj ortakëve tane, partnerëve dhe klientëve.

VLERAT

Nepërmjet rrjetit të shërbimit Inteligent, në sajë të shërbimit të referimit objektiv ofrojmë kompetencë dhe pasion.

ORTAKET E PERFESHIRE

Të tre shoqëritë e përfshira në llogjikën e zinxhirit të furnizimit, kryejnë funksionin e kërkimeve dhe atë të prodhimit teknologjik: Insoft në fakt kryen promovimin dhe transferimin strategjik të rezultateve të perfutuara prej dy shoqërive të tjera; Bi Solution dhe Enter Price.



ENTER PRICE SH.P.K.

U krijua më 1993 si shoqëri konsulence, projektimi dhe kryerje shërbimesh që i përkasin sektorit të Teknologjisë informatike dhe komunikimit teknologjik që aplikohet në fushën e Shëndetësisë dhe Administratës Publike. Sot, ofron shërbime menaxhimi dhe konsulence drejtimi për Administratën Publike falë aftësive të veçanta në këtë sektor përfituar prej konsulentëve; ofron zgjidhje për projektet që kanë të bëjnë me Menaxhimin strategjik, Magazinimin e të dhënave, Kontrollin mbi Menaxhimin, Përmirësimin e cilësisë, Auditimin e Proçeseve, Teknologjinë Integruar.



INSOFT 2000 SH.P.K.

Shoqëria Insoft, që prej vitit 2000, propozon zgjidhje për furnizimet e sistemeve dhe shërbimeve në Administratën Publike, në Shëndetësinë Publike dhe private ku ka përfituar kompetencë dhe referencë në sistemet klinike dhe shëndetësore duke punuar si në cilësinë e konçesionares së ndërmarrjeve të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu edhe nëpërmjet referencave direkte.



BI SOLUTION SH.P.K.

Kjo shoqëri, themeluar në vitin 2002, është një shoqëri konsultimi e biznesit inteligjent që vepron kryesisht në fushën e Shëndetësisë dhe asaj të Administratës Qendrore dhe Lokale. Ofron konsulence për Menaxhimin Strategjik, për kryerjen e Magazinimit të të dhënave, për Kontrollin e Menaxhimit, Përmirësimin e cilësisë, Auditimin e Proçeseve.



I&S Società Consortile a r.l.
Via Ottorino Respighi n.36
Bari - ITALY

Tel. +39 0805486071
Fax +39 0805482573
e-mail: info@iands.it

pooya

I&SEXPOEST



Veprimi i mbështetur nga konsorciumi i Bashimit Evropian për vlerën e PO FESR Puglia 2007/2013, Veprimi 6.3.3, "ndërhjertje mbështetje për projektet e promovimit ndërkombëtar të PMJ, pulceze"



KUSH JEMI

I&S është një shoqëri e përbashkët me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në vitin 2002 e cila merret me "prodhimin dhe komercializimin e sistemeve software dhe hardware, që si objektiv strategjik ka konsultimin sa i përket zbatimit të teknologjive në fushën e Shëndetësisë, Administratës Publike dhe Ndermarrjeve.

I&S nxit, kordinon, rregullon në mënyrë të shkelqyer aktivitetet e partnerëve të konsorciumit falë studimit, projektimit dhe realizimit të veprave, mallrave dhe shërbimeve të sektorit industrial, tregëtar dhe atij të shërbimeve teknologjike në veçanti.

Konsorciumi ka vite që ofron shërbimet në sektorin e ICT-se (informacion dhe komunikim teknologjik), dhe, në veçanti, merret me realizimin dhe aplikimin e sistemeve të komputërimit si për Administratën Publike ashtu edhe për njesitë Private.

Vitet e fundit, në mënyrë të veçantë, i ka kushtuar rendesi aplikimit të sistemeve të komputërimit dhe kryesisht atij të sektorit të Shëndetësisë dhe të Administratës Publike. Falë organizimit të tij, përvojës së konsoliduar si edhe menaxhimit me kualifikim të cilësive së lartë, ky konsorcium është në gjendje të përfaqësojë në mënyrë direkte dhe efikase interesat e ndermarrjeve me të cilat bashkëpunon.

SHERBIMET

Shërbimet profesionale dhe teknologjike që I&S –ja propozon përbejnë Misionin e Ndermarrjes duke garantuar kështu për ortakët, partnerët dhe klientët një "mundësi" konkrete për kompetencat ekzistuese plus vlerën e re të shtuar.

Kështu që, ky volan, na mundëson shtimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e mundësive të reja në synimin e vazhdueshëm për të rritur potencialin nepermjet vision-it.

PROJEKTI

Projekti I&S Ekspoest është një projekt promovimi i një niveli nderkombëtar midis Italisë dhe Shqipërisë, i cili konkurren në arritjen e VIZIONIT (presantimit) aziendal, me qëllim që të shtojë dhe të mbrojë si potencialin e vet personal ashtu edhe atë të përbashkët.

Falë këtij projekti favorizohet një rrugetim internacionalizimi i cili nepermjet pjesëmarrjes në ndermarrjet e përfshira, në mënyrë të vecantë, mundësohet konkretisht rritja e konkurrencës në tregun ballkanas, por edhe në atë lokal të Konsorciumit I&S pikerisht në sajë të vlerës së shtuar që i bëhet përpjekjes për nderkombëtarizim;

Projekti parashikon një rrugetim promovimi të vetë Konsorciumit, që do të realizohet në sajë të mbështetjes nga Krahina e Puljes, nepermjet përfitimit, përforcimit dhe ndarjes së bashku të burimeve, kompetencave dhe të njohurive të praktikuar në futjen dhe në drejtimin e tregut të huaj.

I&S, në hallkën e tregut të paraqitur në projekt, ka përfshirë 3 prej ortakëve me konkurren të cilët janë: Enter Price sh.p.k., Insoft 2000 sh.p.k. dhe Bi.Solution sh.p.k.. Kjo, me qëllim që të krijojë mundësi tregëtare në biznesin e tij, pra, të aplikojë teknologjinë në fushat e prodhimitarise shqiptare si me poshtë vijon:

- Bashkëpunime tregëtare dhe industriale.
- Sektori ligjor (e drejta e shoqërive) dhe fiskal lokal (të dhëna të domosdoshme për të mbështetur rrugetimin e vet të investimit në atë fushë.
- Mbështetje të pranishme se saj në tregun shqiptar për një kohë të mesme - të gjatë që të mund të përfitojë mundësi zhvillimi duke qenë prezent në një zonë ekonomike dinamike.
- Partnership (ortakeri), joint venture (sipërmarrje e përbashkët) dhe bashkëpunime me subjekte ekonomike lokale.
- Gjetja e sektoreve perkates: përqendrimi në sektorin industrial/prodhues.

PROJEKTSYNIMI

Projekti I&S Ekspoest, në sektorin e teknologjive informatike të aplikuar në Administratën Publike, në Shëndetësi si edhe në atë Industrial, identifikon harkun ekonomik të promovimit në zonën ballkanase (Shqipërinë) dhe përcakton qartësisht një rrugetim të strukturuar internacionalizimi të karakterizuar sipas strategjive si me poshtë vijon:

- Spot për Administratën Publike;
- Rregjim;
- Informacion dhe komunikim në ndermarrjet e prodhimeve shqiptare;
- Menaxhimi dhe të dhënat e ndjeshme;
- Tavoline për tavoline në ndermarrje;
- Shkëmbim të njohurive;
- Regjistrime on-line;
- Patenta.

STAF I SPECIALIZUAR

Mbështetja nga ana e personelit pjesëmarrës të brendshëm është vendimtar për realizimin me sukses të projektit. Mbështetja e profesionistëve lokalë si dhe e atyre italianë është themeltare: kompetenca e tyre është e zonja të promovojë mundësi të zhvillimit nderkombëtar të Konsorciumit, të kërkojë partner si edhe të konsiderojë për sipërmarrje të përbashkët në fushën e transferimit teknologjik nderkombëtar. Projekti koordinohet prej një drejtuesi eksporti specialist për zgjedhjet strategjike, frut ky i një studimi të detajuar konkretshmerie, në gjendje të nxisë dege strategjike, në bazë të një analize të pershtatshme të tregut, si dhe duke u bazuar në marrëveshjen me të gjithë stafin menaxhues të konsorciumit.

KONKLUSIONI

Konsorciumi synon të shenojë një rritje nderkombëtare, mendimi është pozitiv dhe ambicja është që të punohet me një vendosmëri me të madhe drejt një stabilizimi në zonën shqiptare, duke pritur kështu mundësi të reja të përvitueshme.